

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË
NDIKIMIT NË MJEDIS PËR
NDËRTIMIN:**

**"STRUKTURË BANIMI DHE SHËRBIME 1, 6
& 9 KATE ME 2 KATE NËNTOKË PARKIM"**

Vendodhja: Rruga "E Kosovareve",
Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë.

Kërkues: "Eldino" sh.p.k

Referuar shtojcës: (sipas ligjit 10440
shtojca II pika 10/b)

Hartoi raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis:
"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k

Administrator
Elidiana Shehu

Altin Ahmeti
(Çert. 261, Nr. 11657 Prot, dt. 10.12.2014)

Ing. Elidiana Shehu
(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)



A blue ink signature of Altin Ahmeti, consisting of several loops and a long horizontal stroke at the bottom.

Tetor, 2016

A blue ink signature of Elidiana Shehu, featuring a large, stylized initial 'E' followed by a cursive name.

TABELA PËRMBLEDHESE

1	TË PËRGJITHSHME.....	3
1.1.	HYRJE.....	3
1.2.	TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	3
2	PËRSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	5
2.1.	TË PËRGJITHSHME.....	5
2.2.	LEGJSLACIONI.....	6
2.3.	PËRMBLEDHJE E KUADRIT LIGJOR.....	6
2.4.	PROÇEDURA E MIRATIMIT MJEDISOR TË PROJEKTIT	8
2.5.	METODOLOGJIA.....	8
3	PËRSHKRIM I PROJEKTIT.....	9
3.1.	QËLLIMI I PROJEKTIT	9
3.2.	TË DHËNA TEKNIKE TË AKTIVITETIT	9
3.3.	VENDODHJA E OBJEKTIT.....	13
3.4.	LIDHJA E OBJEKTIT ME PLANIN E PËRGJITHSHËM VENDOR.....	17
3.5.	LIDHJA E OBJEKTIT ME INFRASTRUKTURËN INXHINIERIKE	18
3.6.	IDENTIFIKIMI I ZONAVE TË MBROJTURA/MONUMENTE KULTURE/MONUMENTET E NATYRËS	18
3.7.	NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR I MBULESËS BIMORE	20
3.8.	INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË AFERSI TË PROJEKTIT.....	20
3.9.	PËRSHKRIMI I PROÇESEVE TEKNOLOGJIKE TË PROJEKTIT.....	21
3.10.	LLOJI, VOLUMI, KONSUMI DHE PRODHIMI I LËNDËVE TË PARA	21
3.11.	INFORMACION PËR SHKARKIMET NË MJEDIS	21
3.12.	CILËSIA E AJRIT, E ZHURMAVE DHE E UJËRAVE SIPËRFAQËSORE NË ZONËN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT	22
4	PËRSHKRIM I MJEDISIT TË RAJONIT	25
4.1.	TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	25
4.2.	INFORMACIONE PËR BASHKINË TIRANË	25
4.3.	MJEDISI FIZIK	27
4.4.	TENDENCAT DEMOGRAFIKE.....	27
4.5.	EKOLOGJIA	28
4.6.	GJEOLOGJIA DHE HIDROGJEOLOGJIA.....	28
4.7.	EKONOMIA.....	28
4.8.	KLIMA	28
4.9.	SIZMICITETI	29
4.10.	GJEOLOGJIA DHE DHERAT	29
5	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË RËNDËSISHME NË MJEDIS	30
5.1	METODIKA E PËRDORUR PËR VLERËSIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS	30
5.2	VLERËSIMI I RËNDËSISË SË NDIKIMEVE TË IDENTIFIKUARA	30
5.3	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.....	31
5.3.1	Identifikimi i ndikimeve te mundshme në fazën e ndërtimit.....	31
6	MASAT PËR PARANDALIMIN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NË MJEDIS	36
6.1	PLANI I MASAVE ZBUTËSE TË NDIKIMEVE NË FAZËN E NDËRTIMIT TË OBJEKTIT	36
7	PROGRAMI MONITORIMIT	40
7.1.	SKEMA E MONITORIMIT TË TREGUESVE MJEDISOR	40
8	KONKLUZIONE	41
	NDIKIMET E MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS	41
	PËRPARËSITË E PROJEKTIT	41

1 TË PËRGJITHSHME

1.1. Hyrje

Nënshkrimi i një sërë konventash dhe miratimi i kuadrit ligjor për mjedisin dhe në funksion të tyre, detyron institucionet shtetërore dhe subjektet fizike e juridike ti nënshtrohen disa procedurave profesionale para miratimit dhe zbatimit të projektit të tyre.

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) është një prej instrumentave parandalues dhe minimizues të ndikimit mjedisor dhe për projektin specifik, hartohet duke u bazuar në zhvillimin strategjik të Bashkisë së Tiranës.

Ky raport përfshin vlerësimin, identifikimin, si dhe përcaktimin e masave zbutëse të ndikimit të zbatimit të projektit “Strukturë Banimi dhe Shërbime 1, 6 & 9 kate me 2 kate nëntokë parkim” me vendndodhje në rrugën “E Kosovareve”, në Nën-Njësinë Strukturore 5-28, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë.

Ky raport i VNM-së po përgatitet me kërkesë të subjektit “Eldino” sh.p.k me administrator z.Ervin Luari. Projekti arkitekturor është realizuar për ndërtimin e një strukture banimi dhe shërbimi. Objekti në tërësinë e tij do të rezervojë edhe 2 kate nëntoke”.

1.2. Të dhëna të përgjithshme

Subjekti “Eldino”sh.p.k për projektin“Strukturë Banimi dhe Shërbime 1, 6 & 9 kate me 2 kate nëntokë parkim” me vendndodhje në rrugën “E Kosovareve”, në Nën-Njësinë Strukturore 5-28, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë, do të paiset me të gjitha miratimet përkatëse.

Subjekti “Eldino”sh.p.k është i paisur me numër NIPT-i: L32308019I dhe me seli rr.”Robert Shvarc”, Nr. 5, pranë Kultit Eleonor, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë.

Zona në studim ndodhet në Nën-Njësinë Strukturore nr.5-28, të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë (në fuqi) dhe është e projektuar si zonë e përzier për zhvillime banimi dhe shërbime publike.

Zona në studim gjendet në një zonë te formuluar urbane në pjesën perëndimore me objekt banimi 12 kat dhe në pjesën lindore me objekte banimi dhe shërbimi 9 kat. Në pjesën veriore është propozuar një zonë e re ndërtimi me objekte 4,6,7,8,9 kat dhe në pjesën jugore është propozuar një zonë e destinuar për shërbime publike 2kat të tipit kopesht-çerdhe. Në shkallë më të gjerë kjo e kthen zonën në një pol shumë të rëndësishëm për qytetin, jo vetëm nga pozicionimi por dhe nga formulimi dhe miksimi i funksioneve publike me ato private.

Hyrja e banorëve bëhet në anën veriore dhe lindore të objektit. Parkimi kryhet direkt nga rruga “Ndreko Rino” në anën perëndimore të objektit.

Objekti, sipas studimit dhe projektit të kryer, ka këto të dhëna urbanistike:

Siperfaqe e tokës që zhvillohet	= 2 605 m²
Siperfaqe e objektit(njolla e objektit)	= 1 245 m²
Sipërfaqe ndërtimi mbi tokë	= 10 215 m ²
Koeficient shfrytëzimi i territorit	= 48%

“STRUKTURË BANIMI DHE SHËRBIME 1, 6 & 9 KATE ME 2 KATE NËNTOKË PARKIM”

Koordinatat e Pronës në Sistemin Shtetëror Gauss-Kruger		
Nr	X	Y
1	44 00 791	45 76 319
2	44 00 842	45 76 329
3	44 00 857	45 76 294
4	44 00 808	45 76 277

Ortofoto e zonës në vlerësim



Ortofoto në lidhje me e qytetin



2 PËRSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

2.1. Të përgjithshme

VNM është një proces sistematik për të përcaktuar dhe vlerësuar efektet apo ndikimet në mjedis të një veprimi apo projekti të caktuar. Në një situatë normale, ky proces aplikohet përpara se të merren vendimet dhe të fillojnë angazhimet për realizimin e projektit. Por sidoqoftë, dhe në çdo kohë, efektet sociale, kulturore dhe shëndetësore janë konsideruar si pjesë integrale e VNM. Kujdes i veçantë i kushtohet praktikave të VNM për të parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative në mjedis dhe shëndet të veprimeve të ndermarra.

Qellimi i VNM-së është të:

- Të japë informacion për vendim-marresit për pasojat mjedisore të studimit e propozuara;
- Të promovojë zhvillimin miqësor dhe të qëndrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura për përmirësimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis.

Reduktimi i ndikimeve në mjedis arrihet nëse një zhvillim bëhet i qëndrueshem me mjedisin. Këto ndikime janë mjaft komplekse, me të mëdha në shkallë dhe për më tepër shtrijne pasojat e tyre vite me para ku u fut koncepti i VNM-se në vendin tonë. Si rezultat, VNM është kthyer në një dokument kyç për vendimarrjen për miratimin e një zhvillimi të propozuar.

Në aspektin ndërkombëtar, roli i VNM është njohur në Principin e 17 të Deklaratës për mjedisin dhe Zhvillimin. VNM, si një instrument kombëtar duhet të aplikohet për aktivitetet e propozuara të cilat pritet që të kenë ndikim negativ në mjedis dhe janë subjekt i një vendimarrjeje të një autoriteti kombëtar.

Qellimi dhe objektivat e VNM mund të ndahen në dy kategori. Qellimi i parë, drejtperdrejtë, është të informojë procesin e vendimarrjes duke identifikuar e konsiderueshme potenciale në mjedis dhe rreziqet e perfitimit e projektit dhe zhvillimit të propozuar. Qellimi afatgjatë i VNM është të promovojë zhvillimin e qëndrueshem duke siguruar që propozimet e projektit nuk minojnë burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesën e komunitet si dhe të njerezëve që lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurtër dhe të drejtpërdrejtë të VNM-së:

1. Përmirësim nga pikëpamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
2. Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrën e duhur dhe me efikasitet;
3. Identifikon masat e duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit apo propozimit;
4. Lehtëson informimin e vendimmarresit, duke përfshirë vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore për zbatimin e projektit të propozuar.

Objektivat afatgjatë të VNM janë:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe përjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe dëmtimet serioze të mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentet përberëse të ekosistemeve;
- Përmirëson aspektet sociale të projektit

2.2. Legjislacioni

Sa me sipër, ky Raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, është mbështetur në legjislacionin mjedisor si me poshtë dhe ka për qëllim që të identifikojë, parashikojë dhe parandalojë ndikimin e këtij aktiviteti në mjedis. Kuadri ligjor për VNM-në sigurohet në mënyrë të drejtperdrejtë nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri: 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe Ligji 10440, datë 07.07.2011 “Për Vleresimin e Ndikimit në Mjedis”. Këto ligje së fundmi janë përafuar plotësisht me ligjet e Bashkimit Europian për mbrojtjen e mjedisit. Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) përcakton tipin dhe shkallën e projekteve apo veprimtarive që kërkojnë VNM për implementimin. Kategoritë e VNM-ve janë:

- VNM Paraprakë
- VNM e Thelluar.

Aktiviteti në vlerësim, në bazë të klasifikimit të tij si aktivitet me ndikim të vogël në mjedis, klasifikohet si raport Paraprak i VNM.

Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponente të veçante dhe të rëndësishme të mjedisit. Kështu, ndër ligjet me specifike që kanë lidhje të drejtperdrejtë me projektin në vlerësim, mund të përmendim:

- Në ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” theksohet në kapitullin V (VNM) nëni 25 se:

Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

- Në Ligjin Nr.10 440, datë 07.07.2011 “Për Vleresimin e Ndikimit në Mjedis” në kreun II, nëni 7 për “Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis” thuhet:

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së dhe licencimi, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin identifikimin, saktësimin dhe vlerësimin e drejtperdrejtë dhe të terthortë të projektit në mjedisin ku do të zbatohet, si dhe përcaktimi i masave për të parandaluar dhe zbutur demtimet në mjedis që në fazën fillestare të tij.

2.3. Përmbledhje e kuadrit ligjor

Menaxhimi dhe mbrojtja e mjedisit janë pjesë e Legjislacionit Shqiptar, Nëni 59(d) i kushtetutës shkruhet se: “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësimin e nismes dhe të përgjegjësive private, synon:

Nëni d): një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të pershtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Sipas Ligjit Nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Ministria e Mjedisit është autoriteti përgjegjës për rishikimin e dokumentit VNM të përgatitur nga ekspertet e licensuar prej ministrisë së mjedisit.

- Përvec Ligjit Nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi edhe Ligjin Nr. 10440 datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, ligji 12/2015 datë 26.02.2015 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440 datë 7.7.2011. Ky ligj është zhvilluar dhe bazuar në Direktivat e EU dhe praktikën ndërkombëtare të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Përgatitja e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të aktivitetit të propozuar është kryer duke u bazuar në aktet ligjorë të mëposhtëm:

- Ligj nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Neni 25, i cili përcakton kërkesën për vlerësimin e ndikimit në mjedis, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërimit të lejeve përkatëse të zhvillimit;
- Ligj nr.10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i cili përcakton dhe specifikon kërkesat për vlerësimin e ndikimit në mjedis, projektet që i nënshtrohen, përgjegjësitë e palëve në proces;
- Ligj nr.9587 datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i cili kërkon ruajtjen dhe mbrojtjen e specieve biologjike dhe mbrojtjen e vlerave biologjike ku përfshihen edhe ekosistemet dhe habitatet. Ligji kërkon që veprimtaritë ose përdorimet e reja në ekosisteme, habitate dhe peizazhe të mbrojtura ose jo të mbrojtura mund të ushtrohen vetëm pasi t’u jenë nënshtruar procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të jenë pajisur me leje mjedisore;
- Ligj nr.8906 datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”, qëllimi i të cilit është të sigurojë mbrojtje të veçantë të përbërësve të rëndësishëm të rezervave natyrore, të biodiversitetit dhe të natyrës, në tërësi, nëpërmjet krijimit të zonave të mbrojtura. Zonat e mbrojtura krijohen për të siguruar ruajtjen dhe ripërtëritjen e habitateve natyrore, të llojeve, të rezervave dhe të peizazheve natyrore. Zhvilluesit e projekteve dhe veprimtarive duhet të zbatojnë projektet e tyre në përputhje me statusin e mbrojtjes së zonave të mbrojtura (duhet të evidentohet prania ose jo e tyre në zonën e projektit dhe masat që duhen marrë);
- Ligj nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i cili ka për qëllim të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut si dhe të sigurojë administrimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet menaxhimit të integruar të tyre;
- Ligj Nr. 10119 datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”
- Ligj nr.9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i cili përcakton kërkesat për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma, mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma;
- Ligj nr.8897 datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i cili sanksionon që personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, vendas ose të huaj, kanë detyrë të ruajnë pastërtinë e ajrit, ta mbrojnë atë nga ndotjet e shkaktuara nga veprimtaria që ushtrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Vendim Nr.1189, Datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të Mjedisit”
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Për menaxhimin e zhurmave”
- Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Për rregulloren e mbrojtjes së publikut nga shkarkimet në mjedis”.
- Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”.
- Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”.

- Vendim nr.99 datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” në të cilin kategorizohen tipet e mbetjeve dhe kriteret për klasifikimin e tyre;
- VKM nr.247 datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”;
- VKM nr.229 datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”;
- Vendim Nr. 686, date 29.07.2015, “Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive dhe afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit te Mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit te deklarates mjedisore.”
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) dhe Ministrisë së Shëndetësisë nr.8 datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”.

2.4. Proçedura e miratimit mjedisor të projektit

Projektet me ndikim në mjedis duhet të ndjekin proçedurën e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të miratohen përpara fillimit të zbatimit të tyre në terren. Bazuar në dispozitat e Ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, veprimtaria e propozuar duhet t’i nënshtrohet proçedurës së Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis (**Shtojca 2, pika 10/b - “Projekte për zhvillime urbane.”**). Mbasi të jetë hartuar raporti i VNM-së, dokumentacioni paraqitet pranë Ministrise se Mjedisit e cila e përcjell për shqyrtim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Në varësi të projektit AKM mund të shprehet me Vendim Paraprak.

2.5. Metodologjia

Për hartimin e raportit të VNM, porositesi vuri në dispozicion të hartuesve të raportit materialin teknik dhe juridik. Ky raport vlerësimi përgatitet me kërkesë të “Eldino”sh.p.k. U kryen inspektime në terren për të konstatuar vendodhjen, karakteristikat territoriale të kësaj zonë, gjendja e faktoreve të mjedisit, si dhe për të tërhequr mendimin e komunitetit të zones dhe zhvillimin e aktivitetit.

Proçedura e miratimit mjedisor të projektit

Kategoria sipas Legjislacionit Shqiptar	Proçedura që Duhet Ndjekur (Duke plotësuar Standartet Shqiptare)
Aneksi i Ligjit 10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” (Lista e veprimtarive të cilat duhet ti nënshtrohen proçedures së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis)	Bazuar në dispozitat e Ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, veprimtaria e propozuar duhet t’i nënshtrohet proçedurës së Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis (Shtojca 2, pika 10/b - “Projekte për zhvillime urbane.”).
Mbasi të jetë hartuar raporti i VNM, dokumentacioni paraqitet pranë Ministrise së Mjedisit e cila e përcjell për shqyrtim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Në varësi të projektit AKM mund të shprehet me <i>Vendim Paraprak</i> .	

3 PËRSHKRIM I PROJEKTIT

3.1. Qëllimi i projektit

Qëllimi i projektit është “Strukturë Banimi dhe Shërbime 1,6 & 9 kate me 2 kate nëntokë parkim” me vendndodhje në rrugën “E Kosovareve”, në Nën-Njësinë Strukturore 5-28, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë.

Zona në studim ndodhet në Njësinë Bashkiake nr.5 të Tiranës, përkatësisht 500m larg Sheshit “Ëllson” dhe 1.5 km larg Sheshit "Skenderbej" në vijë ajrore. Zona në studim kufizohet në mënyrë të drejtperdrejtë me rrugën "E Kosovareve".

Ndërtimi i këtij objekti do të kryhet në përputhje me studimin e përgjithshëm vendor (në fuqi). Sipas planit të përgjithshëm vendor, ky objekt bën pjesë në Nën-Njësinë Strukturore Nr. 5-28, e projektuar si zonë e përzier për zhvillim banimi dhe shërbime publike.

3.2. Të dhëna teknike të aktivitetit

Pronësia e këtij trualli : Alma Simoni, Alush Alla, Dan Kasem Alla, Ilir Hasan Alla, Sadete Alla, Tije Shameti Alla, Xhelal Alla, Xhuvan Alla, Zonje Kardashi, janë bashkëpronarë të pasurive me numër:

Zona kadastrale 8270 me numër pasurie 7/80 + 7/81+ 7/355 + 7/356 + 7/ 357 + 7/664 + 7/666


Zona e marrë në studim ndodhet në rrugën dytesore të “Rrugës së Kosovareve” në zonën pranë digës së liqenit. Kjo zonë kufizohet nga Veriu, me pronë private në prespektive është rrugë me seksion 10m sipas studimit, nga jugu kufizohet me pronë shtet, në perëndim kufizohet me rrugë ekzistuese “Ndreko Rino”, nga lindja me pronë private në prespektive është rrugë me seksion 10m sipas studimit.

Zhvillues i projektit “Strukturë Banimi dhe Shërbime 1, 6 & 9 kate me 2 kate nëntokë parkim” do të jetë Subjekti “Eldino”sh.p.k i paisur me NIPT-i: L32308019I dhe me seli rr.”Robert Shvarc”, Nr. 5, pranë Kultit Eleonor, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë. z.Ervin Luari.

Subjekti, për realizimin e projektit do të pajiset me të gjitha miratimet përkatëse të lejeve të nevojshme për ndërtimin e tij. Ky objekt ndërtohet në përputhje me planin urbanistik të zonës (PPV), ku kjo zonë është projektuar si zonë e përzier me zhvillim Banimi dhe shërbime publike.

Zona në studim gjendet në një zonë të formuluar urbane në pjesën perëndimore me objekt banimi 12 kat dhe në pjesën lindore me objekte banimi dhe shërbime 9 kat. Në pjesën veriore është propozuar një zonë e re ndërtimi me objekte 4,6,7,8,9 kat dhe në pjesën jugore është propozuar një zonë e destinuar për shërbime publike 2kat të tipit kopesht-çerdhe. Në shkallë më të gjerë kjo e kthen zonën në një pol shumë të rëndësishëm për qytetin, jo vetëm nga pozicionimi por dhe nga formulimi dhe miksimi i funksioneve publike me ato private.

Hyrja e banorëve bëhet në anën veriore dhe lindore të objektit. Parkimi kryhet direkt nga rruga “Ndreko Rino” në anën perëndimore të objektit.



Përshkrimi i gjendjes ekzistuese

Zona e propozuar për zhvillim gjendet në një zonë të formuluar urbane në pjesën perëndimore me objekt banimi 12 kat dhe në pjesën lindore me objekte banimi dhe shërbimi 9 kat. Në pjesën veriore është propozuar një zonë e re ndërtimi me objekte 4,6,7,8,9 kat dhe në pjesën jugore është propozuar një zonë e destinuar për shërbime publike 2kat të tipit kopësht - çerdhe. Në shkallë më të gjerë kjo e kthen zonën në një pol shumë të rëndësishëm për qytetin jo vetëm nga pozicionimi por dhe nga formulimi dhe miksimi i funksioneve publike me ato private.

Brenda zonës në studim aktualisht ndodhen disa godina egzistuese 1 dhe 2 katëshe, në gjendje të amortizuar, të cilat përdoren me funksion shërbimi, si lavazh, parking etj. Mungon infrastruktura urbane, gjelbërimi urban dhe infrastruktura rrugore.

Përshkrimi i konceptit urbanistik

Projekti parashikon lartësinë 1,6,9 kat të godinave duke lejuar krijimin e një silueti të vazhduar të objekteve të banimit. Volumetria në trajt L është konceptuar nga 4 masa të forta volumore të cilat kontrastojnë fort njera-tjetrën duke lehtësuar masën dhe duke e bërë me dinamike volumetrike. Objekti i propozuar merr parasysh distancat urbane të përcaktuara në Rregulloren e Urbanistikës në pjesën perëndimore nga aksi i rrugës ekzistuese “Ndreko Rino” dhe distancat objekt - objekt, në pjesën veriore distancat objekt - objekt me planin e

“STRUKTURË BANIMI DHE SHËRBIME 1, 6 & 9 KATE ME 2 KATE NËNTOKË PARKIM”

ri të propozuar, në lindje distancat nga aksi i rrugës së parashikuar në projekt si dhe distancat objekt - objekt me kompleksin 10 kat, në pjesën jugore janë mbajtur distancat nga kufiri i pronës. Parkimi kryhet direkt nga rruga “Ndreko Rino” në anën perëndimore të objektit. Hyrja e banorëve bëhet në anën veriore dhe lindore të objektit.

Plan i detajuar i përdorimit të tokës



Lartësia maksimale e propozuar e objektit kullë brenda zonës në studim është 9 kate. Lartësia minimale e strukturës për katet banim është 3.06m, për katet tregëtare është 4m – 5m. Numri i vendparkimeve do të saktësohet mbi bazën e sipërfaqeve ndërtimore të propozuara në fazën e aplikimit për leje zhvillimi, sipas kriterit 1 vendparkim për cdo 100m² ndërtim. Daljet konsol përtej gjurmës për ballone nuk e kalojnë vijën e ndërtimit. Hapësirat rekreative do të paisen me gjelbërim të mesëm dhe të lartë dhe elementë të mobilimit urban, si stola, ndricues etj. Këto hapësira do të realizohen duke iu referuar minimalisht standartit 2.5 m² gjelbërim/banorë.

Objekti, sipas studimit dhe projektit të kryer, ka keto te dhena urbanistike:

Sipërfaqe e tokës që zhvillohet	= 2 605 m ²
Sipërfaqe e objektit(njolla e objektit)	= 1 245 m ²
Sipërfaqe ndërtimi mbi tokë	= 10 215 m ²
Koeficient shfrytëzimi i territorit	= 48%

Koordinatat e Pronës në Sistemin Shtetëror Gauss-Kruger		
Nr	X	Y
1	44 00 791	45 76 319
2	44 00 842	45 76 329
3	44 00 857	45 76 294
4	44 00 808	45 76 277

“STRUKTURË BANIMI DHE SHËRBIME 1, 6 & 9 KATE ME 2 KATE NËNTOKË PARKIM”

Pamje në 3D e zonës në studim



“STRUKTURË BANIMI DHE SHËRBIME 1, 6 & 9 KATE ME 2 KATE NËNTOKË PARKIM”

mëposhtëme, zona në studim është zonë me godina egzistuese 1 dhe 2 katëshe, në gjendje të amortizuar. Mungon infrastruktura urbane, gjelberimi urban dhe infrastruktura rrugore.

Foto nga vendndodhja e zones në studim



“STRUKTURË BANIMI DHE SHËRBIME 1, 6 & 9 KATE ME 2 KATE NËNTOKË PARKIM”



“STRUKTURË BANIMI DHE SHËRBIME 1, 6 & 9 KATE ME 2 KATE NËNTOKË PARKIM”



3.4. Lidhja e objektit me Planin e Përgjithshëm Vendor



LEGJENDA	
	A. Banimi Përdorimet e lejuara të kategorisë së banimit
	P. A.SHP. Përzler - Banim, Shërbime Publike Përdorimet e lejuara të kategorisë së banimit Përdorimet e lejuara të kategorisë shërbime publike
	P. A.SHP.-N. Përzler - Banim, Shërbime Publike, park natyror Përdorimet e lejuara të kategorisë së banimit Përdorimet e lejuara të kategorisë shërbime publike
	P. SHP. I Përzler - Shërbime Publike, Industri Përdorimet e lejuara të kategorisë shërbime publike Përdorimet e lejuara të kategorisë industri
	P. A.SHP. I Përzler - Banim, Shërbime Publike, Industri Përdorimet e lejuara të kategorisë së banimit Përdorimet e lejuara të kategorisë shërbime publike Përdorimet e lejuara të kategorisë industri
	P. A.N. Përzler - Banim, Përdorim Natyror Përdorimet e lejuara të kategorisë së banimit Përdorimet e lejuara të kategorisë përdorim natyror
	P. A.M.SHP. Përzler - Banim, Monumente, Shërbime Publike Përdorimet e lejuara të kategorisë së banimit Përdorimet e lejuara të kategorisë monumente Përdorimet e lejuara të kategorisë shërbime publike
	P. A.M.SHP. V. Përzler-Banim, Monumente, Shërbime Publike, I Veçantë Përdorimet e lejuara të kategorisë së banimit Përdorimet e lejuara të kategorisë monumente Përdorimet e lejuara të kategorisë shërbime publike dhe të kategorisë përdorim i veçantë
	P. A.SHP.SHI. Përzler - Banim, Shërbime Publike, Infrastrukturore Përdorimet e lejuara të kategorisë së banimit Përdorimet e lejuara të kategorisë shërbime publike Përdorimet e lejuara të kategorisë shërbime publike infrastrukturore
	SHP. Shërbime Publike Përdorimet e lejuara të kategorisë shërbime publike

Zona në studim bën pjesë në Nën-Njësinë Strukturore Nr.5-28, të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë (plani në fuqi). Sipas këtij plani, kjo zonë është e përcaktuar si zonë e përzler me zhvillim Banimi dhe Shërbime Publike. Zona në studim gjendet në një zonë të formuluar urbane në pjesën perëndimore me objekt banimi 12 kat dhe në pjesën lindore me objekte banimi dhe shërbimi 9 kat. Në pjesën veriore është propozuar një zonë e re ndërtimi me objekte 4,6,7,8,9 kat dhe në pjesën jugore është propozuar një zonë e destinuar për shërbime publike 2kat të tipit kopesht-çerdhe. Në shkallë më të gjerë kjo e kthen zonën në një pol shumë të rëndësishëm për qytetin, jo vetëm nga pozicionimi por dhe nga formulimi dhe miksimi i funksioneve publike me ato private.

3.5. Lidhja e objektit me infrastrukturën Inxhinierike

Objekti, në bazë të studimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, do të pajiset me të gjithë infrastrukturën inxhinierike të nevojshme. Ndërtimi i këtij objekti nuk do të ndikojë në dëmtimin ose devijimin e infrastrukturës inxhinierike ekzistuese. Objekti do të plotesojë nevojat e tij për ujë higieno-sanitar nëpërmjet shfrytëzimit të rrjetit ekzistues dhe përsa i përket sistemit të shkarkimit të ujërave të zeza, do të lidhen me kanalizimet ekzistuese në zonë siç janë ato të objekteve të ndërtuara me herët.

Mbetjet e ngurta do të menaxhohen në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë dhe do të percaktohet vendi i depozitimit të tyre nga Bashkia, pasi të jetë miratuar leja e zhvillimit. Pastrimi i mbetjeve urbane do të kryhet nëpërmjet vendosjes së koshave të mjaftueshem për banoret dhe shërbimi i pastrimit të mbetjeve të ngurta urbane do të kryhet nga firma pastruese e zonës.

Në këtë fazë të projektit nuk është përcaktuar ende destinacioni i mbetjeve inerte.

3.6. Identifikimi i Zonave të Mbrojtura/Monumente Kulture/Monumentet e Natyrës

“Zona të mbrojtura” shpallen territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat menaxhohen me rrugë ligjore dhe me metoda shkencore bashkëkohore.

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN. Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive. Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës pyjet me vlerë shkencore, biologjike, historike dhe didaktike. Zona në vlerësim nuk vlerësohet si zone me status të veçantë nga MM. Siç shihet edhe në hartën e mëposhtme, zona në vlerësim nuk përmban sipërfaqe të mbrojtura.

Përveç zonave të mbrojtura, sipas hartës mund të kemi edhe zona të tjera të cilat mund të jenë të llojit:

- a) Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor/ (Kategoria I);
- b) Park kombëtar (Kategoria II);
- c) Monument natyror (Kategoria III);
- ç) Rezervat natyror i menaxhuar/zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve (Kategoria IV)
- d) Peizazh i mbrojtur (Kategoria V);
- dh) Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara/zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë (Kategoria VI).

Rreth një zone të mbrojtur mund të shpallet një zonë buferike perimetrale e zonës së mbrojtur.

Përveç statusit të mësipërm të zonave të mbrojtura të cilat paraqiten në hartë, Zonë e Mbrojtur mund të jenë edhe objekte të veçanta me status “Monument Natyror”, të cilat për rajonin në vlerësim sipas Ligjit në fuqi janë si më poshtë:

“STRUKTURË BANIMI DHE SHËRBIME 1, 6 & 9 KATE ME 2 KATE NËNTOKË PARKIM”

Ortofoto e zonës në vlerësim



Siç duket qartë edhe në ortofoton e mësipërme, sipërfaqja në të cilën do ndërtohet objekti nuk çënon Monumentet e Kulturës, Zonat e Mbrojtura dhe Monumentet e Natyrës, objekti ndodhet në një zonë të përcaktuar si zonë e përzier banimi dhe shërbimesh publike, brenda vijës së verdhë të qytetit dhe ka një distancë prej 125 m në vijë ajrore me Liqenin e Tiranës, i cili është shpallur si Brez i Gjellbër.

3.7. Një përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore

Zona pranë sipërfaqes së projektuar për "Strukturë Banimi dhe Shërbime 1, 6 & 9 kate me 2 kate nëntokë parkim" në rrugën "E Kosovareve" është një zonë kryesisht me bimësi të pazhvilluar. Mungon pemët dekorative dhe bimësia urbane në përgjithësi. Pranë zonës në studim dallohet një sasi e vogël bimësie barishtore, vihet re mungesa e bimëve të larta dekorative apo e specieve të ndryshme. Në largësinë 150 m në vijë ajrore ndodhet Liqeni i Tiranës i klasifikuar si Brez i Gjellbër, i pasur me bimësi të ulët dhe bimësi të lartë, i cili i jep frymëmarrje jo vetëm zonës në studim por edhe qytetit të Tiranës.

3.8. Informacion për praninë e burimeve ujore në afersi të projektit

Në zonës në studim nuk ndodhet asnjë burim ujqor. Pranë zonës në studim ndodhet Liqeni i Tiranës në një distancë prej 250m në vijë ajrore.



3.9. Përshkrimi i proceseve teknologjike të projektit

Proceset teknologjike në këtë projekt janë ato të fazës ndërtimore, nëpërmejt punimeve të ndërtimit të cilat do të kryhen nga firma ndërtuese.

Disa prej proceseve kryesore të punimeve ndërtimore do të jenë:

- Objekti do të rrethohet me skeleri dhe do të jetë i veshur me rrjetë mbrojtëse deri në momentin e përfundimit të punimeve.
- Patinime me stuko betoni. Betonimi i themeleve;
- Punimet e mbulesës së objektit;
- Instalime elektrike, hidrosanitare, ngrohje-ftohje;
- Pastrimi i sheshit të ndërtimit nga objektet ekzistuese në këtë zonë.
- Gërmimi dhe hapja e themeleve të objektit
- Betonimi i themeleve
- Ngritja e strukture prej betoni dhe hekuri (betoni blihet i gatshëm nga prodhuesit)
- Punimet e mbulesës së objektit
- Muratura, suvatimet, etj
- Sistemimi i shesheve të lira rreth objektit, rrugët hyrëse e dalëse
- Rehabilitimi i hapsirave të gjelbërta të projektuara, etj.

3.10. Lloji, volumi, konsumi dhe prodhimi i lëndëve të para

Lëndët e para të përdorura do të jenë kryesisht llaçi i betonit, i cili blihet i gatshëm nga firmat e prodhimit të betonit në zonë, hekuri për strukturën mbajtëse të objektit, tulla dhe tjegulla për mbushjen e mureve dhe të mbuleses, material poliesteroli për izolim, rërë dhe gëlqere për suvatimin e mureve, dyer dhe dritare duralumini të gatshme dhe instalimet inxhinierike të brendshme. Objekti do të jetë me destinacion banimi dhe shërbimi, dhe për këto arsye nuk vlerësohet si aktivitet me ndikim në mjedis gjatë fazës së shfrytëzimit të tij. Shkarkimet e ujerave të zeza, do të lidhen me sistemin e kanalizimeve të zonës.

3.11. Informacion për shkarkimet në mjedis

Shkarkimet në mjedis gjatë fazës ndërtimore do të jenë kryesisht pluhurat nga punimet e ndërtimit (LNP), si dhe zhurmat në mjediset e punës nga makinerite e punimeve të ndërtimit. Ky efekt mund të transmetohet edhe në mjediset e zonës përreth nëse nuk kryhet larja dhe pastrimi i mjeteve para daljes së tyre nga kantieri dhe lagia e sipërfaqeve të pa shtruara gjatë sezonit të thatë. Këto ndikime do të jenë të përkohshme dhe nuk do të kenë veti akumuluese në mjedisin e zonës. Mbetjet e ngurta nga faza ndërtimore do të jenë ambalazhe të produkteve të ndryshme të cilat janë të riciklueshme dhe do të menaxhohen nga firma pastruese e territorit urban.

Përsa i përket mbetjeve inerte nga prishja e objekteve ekzistuese, ato do të shkarkohen në vendin e përcaktuar paraprakisht nga Bashkia Tiranë. Gjatë fazës së funksionimit, nga aktiviteti human do të ketë shkarkime të

ujërave të ndotura, të cilat kanë cilësinë e ujerave urbane si në të gjitha zonat e tjera të banuara. Këto shkarkime do të kryhen në sisemin ekzistues të kanalizimeve të zonës.

Përsa i përket sasisë së dheut që do të hiqet nga sheshi i ndërtimit, ajo është relativisht e madhe. Sipas llogaritjeve inxhinierike sasia e materialeve inerte që do të gjenerohen nga prishja e ndërtimeve egzistuese dhe nga gërmimi i tokës dhe përshtatja e sipërfaqes për ndërtim do të jetë afërsisht **8 550 m³**. Ky proces është ende një problem serioz për zhvilluesit sot, ku ende nuk është përcaktuar përfundimisht mënyra e menaxhimit të tij. Aktualisht, subjektet private e transportojnë atë për një rrugë të gjatë deri në periferi të qytetit, duke e shkarkuar në zona të përcaktuara nga Bashkia Tiranë për rehabilitimin e karrierave ekzistuese. Transportimi i këtij materiali përbën një shkak për rritjen e ndotjes në qytet dhe kosto të larta për investitorin dhe blerësit e ambjenteve të reja të objektit që ndërtohet.

3.12. Cilësia e ajrit, e zhurmave dhe e ujërave sipërfaqësore në zonën e zbatimit të projektit

Për zonën e Tiranës janë publikuar disa të dhena të monitorimit të cilësisë së mjedisit nga raporti vjetor i monitorimit të mjedisit nga Ministria e Mjedisit. Janë kryer matje të elementeve të mjedisit të zonës pranë zonës në studim nga Ministria e Mjedisit dhe nga Agjensia Kombëtare e Mjedisit për vitin 2015.


Më poshte po ju paraqesim rezultatet e monitorimit të ajrit dhe zhurmave për qytetin e Tiranës të monitoruara nga Ministria e Mjedisit. Për realizimin e procesit të monitorimit janë zbatuar metodat standarte, sipas të cilave përcaktohen mesataret kohore të monitorimit të cilësisë së ajrit, bazuar në direktiven CAFÉ të BE për një ajer të pastër dhe kërkesave të EEA për raportimet.

Situata e cilësisë së ajrit urban në qytetin e Tiranës dhe në zonën në studim

Në kuadër të vlerësimit të situatës së ndotjes së ajrit urban, gjatë tremujorit të parë të vitit 2015 janë realizuar ekspedita në disa pika të qytetit të Tiranës. Këto ekspedita janë realizuar në zona me trafik të rënduar si 21 dhjetori, DSHP, Inspektoriat i Mjedisit, si dhe zona larg trafikut si liqeni artificial dhe rezidenca Rolling hills ne Sauk. Monitorimi është realizuar me stacionin e lëvizshëm për treguesit kryesor të cilësisë së ajrit si : PM10, SO₂, NO₂, O₃, CO, BTEX


Nga të dhënat e monitoruara nga Agjensia Kombëtare e Mjedisit dhe Ministria e Mjedisit për këtë periudhë rezulton se kemi një nivel të lartë ndotjeje për ndotësit PM10, NO₂, SO₂ dhe Benzen që kryesisht emëtohen në atmosferë si rezultat i shkarkimit të automjeteve, pluhurit të rrugëve që gjenerohen gjatë qarkullimit të tyre. Sii dhe nga industria e përpunimit të naftës dhe nënprodukteve të saj.

Graf.1




Nivelet më të larta të PM10 janë monitoruar në stacionet e 21 Dhjetorit ku vlera mesatare e monitoruar është 112 $\mu\text{g}/\text{m}^3$, në stacionin e Inspektoriatit të Mjedisit ku vlera mesatare e monitoruar është 65.99 $\mu\text{g}/\text{m}^3$. Në zonën në studim, e cila ndodhet pranë Liqenit Artificial, vihet re se vlerat mesatare të PM10 janë brenda normave të lejuara.

Graf .2



Nivelet më të larta të NO₂ janë monitoruar në stacionet e 21 Dhjetorit ku vlera mesatare e monitoruar është 70.57 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ dhe në stacionin e Inspektoriatit të Mjedisit ku vlera mesatare e monitoruar është 52.09 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ nga 40 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ që është vlera limite e normës së BE. Në zonën në studim e cila ndodhet pranë Liqenit Artificial, vihet re se vlerat mesatare të NO₂ janë brenda normave të lejuara.

Graf .3



Nivelet më të larta të benzenit janë monitoruar në stacionet e 21 Dhjetorit ku vlera mesatare e monitoruar është 7.38 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ nga 5 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ që është vlera limite vjetore e normës së BE, ndërsa në stacionin e Inspektoriatit të Mjedisit vlera mesatare e monitoruar përafrohet me normën e BE por nuk e tejkalon atë. Në zonën në studim e cila ndodhet pranë Liqenit Artificial, vihet re se vlerat mesatare të Benzenit janë brenda normave të lejuara nga legjislacioni shqiptar dhe BE.

Situata e zhurmave në qytetin e Tiranës dhe në zonën në studim

Vlera mesatare e nivelit te zhurmave të monitoruara në qytetin e Tiranës për Ditën dhe Natën.

Qyteti	LAeq/Diten dB (A)	LAeq/Naten dB (A)
Tirane	65.56	57.82

“STRUKTURË BANIMI DHE SHËRBIME 1, 6 & 9 KATE ME 2 KATE NËNTOKË PARKIM”

Niveli mesatar i zhurmave LAeq/Diten dhe LAeq/Naten, për qytetin e Tiranës është mbi standartin e BE-së dhe Ligjit Shqiptar. Një nga arsyet më kryesore është ndikimi i trafikut të rënduar dhe fakti që për zhurmat nuk është marrë ndonjë masë paraprake për minimizimin e tyre.

Vlera mesatare e nivelit të zhurmave në 15 pikat e monitorimit të qytetit të Tiranës ditën dhe natën.

Pikat e monitorimit	LAeq/Diten	LAeq/Naten (dB (A))
Përballë Stadiumit Dinamo	64.5	53.4
Skënderbeu	71.5	60.2
Kryqëzimi tek Selvia	72	57.3
Rruga e Elbasanit	74.3	60.5
Parlamenti i Panjohur	70	57.8
Kryqëzimi Drejtorisë e Policisë	63.9	53.1
Tek Shkollja 11 Janari	65	53.9
Lapradë	72.5	61.6
Farmacia 10	70.4	63.3
Përballë Shkolles se Bashkuar	63	53.3
Stacioni i Tramit	65.6	62.8
Palati i Kongresave	66.4	51.9
Kryq. 21 Dhjetori	69.4	61.5
Kryq. Vasil Shanto	66.7	57.7
Ish Blloku (B. A.)	62.9	60.6
Standarti i BE	55	45

Vlerat mesatare të nivelit të zhurmave në qytetin e Tiranës, për vitin 2015, në pjesën më të madhe të pikave të monitorimit paraqiten më të larta se standartet e BE-se dhe ligjit Shqiptar si për periudhën e ditës ashtu edhe për atë të natës. Në zonën në studim nuk është vendosur stacion monitorimi, ndaj po iu referohemi pikave më të afërta të monitorimit, të cilët janë stacioni i monitorimit në zonën e Stadiumit Dinamo dhe stacioni pranë shkollës “Edit Durham”. Tek të dyja këto stacione vihet re tejkalimi i normave të lejuara të zhurmës për ditën dhe për natën.

Rezultatet e monitorimit në Liqenin Artificial të Tiranës

Referuar vlerave të nevojës kimike për oksigjen (NKO), Liqeni Artificial i Tiranës paraqet një gjendje eutrofike ku duket qartë impakti i shkarkimeve urbane në liqen. I njëjti arsyetim vlen edhe për nevojën biokimike për oksigjen (NBO) ku rezultati i marrë referuar Direktives Kuader të Ujit, e klasifikon në gjendje eutrofike. Përmbajtja e azotit rezulton e ulët (< 1 mg/l). Vlerat e përmbajtjes së nitrateve variojnë nga 0.02-0.15 mg/l duke i klasifikuar ujërat e liqeneve të cilesisë oligotrofike. Përmbajtja e fosforit është faktori kryesor që përcakton shkallën e eutrofikimit në ujërat e liqenit.

Vlerat e monitorimit paraprak të kryer nga Agjensia Kombëtare e Mjedisit nuk e tejkalojnë vlerën kufi të ujerave oligotrofike 10 µg/l. Përmbajtja e këtij parametri varin nga perqendrimi < 0.005 mg/l – 0.045 mg/l. Referuar këtij parametri ujërat klasifikohen si oligotrofikë. **Pra si klasifikim ujrat e liqenit artificial paraqesin gjendje mezotrofike (mesatare). (Referuar AKM-së)**

4 PËRSHKRIM I MJEDISIT TË RAJONIT

4.1. Të dhëna të përgjithshme

Objekti në vlerësim “Strukturë Banimi dhe Shërbime 1, 6 & 9 kate me 2 kate nëntokë parkim” me vendndodhje në rrugën “E Kosovareve”, në Nën-Njësinë Strukturore 5-28, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë.

Zona në studim ndodhet në Njësinë Bashkiake nr.5 të Tiranës, përkatësisht 500m larg Sheshit “Ëillson” dhe 1.5 km larg Sheshit "Skenderbej" në vijë ajrore. Zona në studim kufizohet në mënyrë të drejtpërdrejte me rrugën "E Kosovareve".

4.2. Informacione për Bashkinë Tiranë

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Tiranës kufizohet në veri me bashkitë Vorë, Kamëz dhe Krujë, në verilindje me bashkinë Klos, në lindje me bashkitë Bulqizë dhe Librazhd, në jug me bashkitë Elbasan dhe Peqin dhe në perëndim me bashkitë Rrogozhinë, Kavajë, Durrës dhe Shijak.



Popullsia: Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Tiranë banojnë 557,422 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil banojnë 757,361 banorë. Me një sipërfaqe prej 1,110.03 km², densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit është 502 banorë/ km² ndërsa sipas Regjistrimit Civil, densiteti është 682 banorë km².

Kjo bashki përbëhet nga 25 njësi administrative, të cilat janë: 11 lagjet e qytetit të Tiranës, Petrela, Farka, Dajti, Zall-Bastari, Bërzhita, Krraba, Baldushku, Shëngjergji, Vaqarri, Kashari, Peza, Ndroqi dhe Zall Herri. Të gjitha njësitë e bashkisë së re Tiranë janë pjesë e rrethit Tiranë dhe qarkut Tiranë, me përjashtim të qytetit të Tiranës, i cili historikisht ka qenë rreth më vete. Në territorin e kësaj bashkie ka dy qytete dhe 135 fshatra.

“STRUKTURË BANIMI DHE SHËRBIME 1, 6 & 9 KATE ME 2 KATE NËNTOKË PARKIM”

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Tiranë	Qyteti Tiranë	Tiranë	Njësia bashkiake nr.1, Njësia bashkiake nr.2, Njësia bashkiake nr.3, Njësia bashkiake nr.4, Njësia bashkiake nr.5, Njësia bashkiake nr.6, Njësia bashkiake nr.7, Njësia bashkiake nr.8, Njësia bashkiake nr.9, Njësia bashkiake nr.10, Njësia bashkiake nr.11	557,422	757,361	1110.03
		Petrelë	Fshatrat; Petrelë, Mullet, Stërmas, Picall, Shënkoll, Gurrë e Madhe, Gurrë e Vogel, Dalias, Barbas, Fikas, Mangull, Qeha, Shytaj, Hekal, Kryezi, Percëllesh, Durishtë			
		Farkë	Fshatrat; Farkë e Madhe, Farkë e Vogel, Lundër, Mjull Bathore, Sauk, Selltë			
		Dajt	Fshatrat; Linzë, Shishtufinë, Tujan, Brrar, Ferraj, Priskë e Madhe, Surrel, Lanabreges, Shkallë, Qafmollë, Darshen, Selbë, Murth			
		Zall-Bastar	Fshatrat; Zall-Bastar, Bastar i Mesem, Bastar – Murriz, Vilëz, Zall-Mner, Mner i Sipërm, Bulçesh, Zall Dajt, Besh, Dajt, Shëngjin i vogel, Selltë Mall			
		Bërzhitë	Fshatrat; Ibë, Bërzhitë, Dobresh, Ibë e Poshtme, Pëllumbas, Mihajës-Cirmë, Kus, Fravesh, Kllojkë, Pashkashesh, Lugë-Shalqizë, Rozaverë			
		Krrabë	Qyteti Krrabë, Fshatrat; Mushqeta, Skuterë			
Baldushk	Fshatrat; Baldushk, Mumajes, Fushas, Balshaban, Shpatë, Isufmuçaj, Mustafakoçaj, Koçaj, Kakunj, Vesqj, Parret, Shënkoll, Vrap, Shpat i sipërm					

		Shëngjergj	Fshatrat; Shëngjergj, Verri, Urë, Burimas, Shëngjin, Façesh, Bizë, Fage, Parpujë, Vakumone, Domje, Derje			
		Vaqarr	Fshatrat; Vaqarr, Allgjatë, Arbanë, Bulticë, Damjan-Fortuzaj, Gropaj, Lalm, Prush, Vishaj, Sharrë			
		Kashar	Fshatrat; Kashar, Yzberish, Mëzez, Yrshek, Katundi i Ri, Kus, Mazrek			
		Peze	Fshatrat; Pezë e Madhe, Pezë Helmës, Pezë e Vogel, Varosh, Maknor, Dorëz, Gror, Grecë, Pajanë, Gjysylkanë			
		Ndroq	Fshatrat; Ndroq, Zbarqe, Kërçukje, Zhurje, Lagje e re, Pinet, Sauqet, Çalabërzezë, Shesh, Grebllesh, Mënik			
		Zall-Herr	Fshatrat; Zall - Herr, Dritas, Çerkezë-Morinë, Qinam, Kallmet, Herraj, Pinar, Priskë e Vogel, Radhesh			

Tirana do të jetë bashkia më e madhe në vend si për nga popullsia, ashtu edhe nga territori. Ajo shtrihet në tri zona gjeografike të veçanta; zona bujqësore në veri, perëndim dhe jug, zona urbane e Tiranës dhe e katër komunave rrethuese, pjesërisht të urbanizuara si dhe zona e thyer malore në lindje. Tirana rezulton bashkia me normën më të lartë të urbanizimit për kilometër katror, pas bashkisë së Durrësit.

Tirana është një zonë e pasur me burime ujore, pasi përshkohet nga lumenjtë Erzen, Lumi i Tiranës dhe Lumi Tërkuzë. Në territorin e saj ndodhen edhe një numër i konsiderueshëm liqenesh artificiale, të ndërtuara si në zonat malore, ashtu edhe në ultësi. Në territorin e bashkisë së re gjendet edhe Parku Kombëtar i Dajtit.

Qyteti i Tiranës është zemra ekonomike e Shqipërisë, me përqendrimin e numrit më të madh të bizneseve në shkallë vendi si dhe me zhvillimin e industrisë së lehtë. Fuqia ekonomike e Tiranës dallohet te sasia shumë më e lartë e kursimeve dhe e kreditit në rang kombëtar, te të ardhurat tatimore, të cilat në masë dërrmuese realizohen në Tiranë si dhe te zhvillimi i sektorit të ndërtimit.

Zonat bujqësore të Tiranës janë përqendruar në shkallë të gjerë të blegtoria dhe prodhimet e qumështit, por edhe tek agroturizmi. Zonat kodrinore rreth Tiranës kanë gjithashtu traditë ullirin dhe drurët frutorë.

Të territorin e Tiranës gjenden disa vendburime qymyrguri të pashfrytëzuara, ndërsa aktiviteti më i përhapur sa i përket shfrytëzimit të burimeve natyrore është përpunimi i gurit për ndërtim dhe atij dekorativ.

Njesite administrative që rrethojnë Tiranën; Dajti, Farka, Vaqarri apo Kashari kanë dalë përtej klasifikimit “qendër e banuar rurale” Plotësimi i nevojave të zonave të reja urbane me kanalizime dhe ujë të pijshëm kërkon investime të konsiderueshme dhe një strategji të qartë.

Njesia administrative e Kasharit, e cila përfshihet në territorin e bashkisë së re konsiderohet zona më e industrializuar e vendit, si pasojë e përqendrimit të bizneseve dhe industrisë përgjatë autostradës Tiranë-Durrës. Mbrojtja e mjedisit dhe kufizimi i ndotjes nga gazrat e makinave konsiderohet një problem emergjent për Tiranën, në kushtet kur qyteti ka kostot më të larta të transportit me taksi apo ka hapësira shumë të pakta për qarkullimin me biçikleta. Një mendësi e re në shpërndarjen e lejeve të ndërtimit konsiderohet emergjente për Tiranën, e cila vuan nga betonizimi dhe reduktimi drastik i hapësirave të gjelbra. Zgjerimi i qytetit drejt njesive administrative përreth krijon mundësi për të shfryrë presionin për leje ndërtimi ndërtim përmes zhvillimit të hapësirave të reja urbane.

Hartimi i planeve urbanistike tërësore në përputhje me kuadrin ligjor aktual të konsultimit publik si dhe transparenca e planeve urbanistike mund të ndihmojë në mbrojtjen e qytetit nga ndërtimet abuzive me apo pa leje.

4.3. Mjedis i Fizik

Qyteti i Tiranës zë vend në një rrafshinë midis Lumit Lana dhe Lumit Tirana. Kjo rrafshinë bën pjesë në një rrafshinë më të madhe ku ndodhen Kruja dhe Lezha, ujërat e të cilave rrjedhin drejt veriperëndimit. Mbi rrafshinë ngrihet 1600 metra Mali i Dajtit, i cili dominon horizontin në perëndim të qytetit. Kodrat më të ulëta të Saukut, Kërrabës dhe Vaqarit, që ngrihen 300 metra, rrethojnë luginën, përkatësisht në perëndim, lindje dhe jug. Kodrat më të ulëta formojnë vargje kodrash deri në bregdetin e Adriatikut me dy korridore nga Durrësi, gjë që lejon me lehtësi komunikimin me bregdetin dhe lejon gjithashtu mbërritjen e rrymave ajrore detare deri në Tiranë. Me zgjerimin e qytetit, zona midis lumenjve tashmë është urbanizuar plotësisht dhe zhvillimi është shtrirë në kodrat përreth qytetit. Korridori verior drejt bregdetit, i cili lidh Tiranën me Durrësin ka njohur gjithashtu zhvillim të madh me një përzierje veprimtarish komerciale, të industrisë së lehtë e rezidenciale. Ndërtimet në perëndim, në Malin e Dajtit janë një problem serioz, ku shpyllëzimi dhe urbanizimi, përveç përkeqësimit estetik të zonës, pritet të rrisë nivelin e rrëshqitjeve dhe mund të paraqesë rreziqe serioze përmbytjeje për qytetin.

4.4. Tendencat Demografike

Popullsia: Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Tiranë banojnë 557,422 banorë, ndërsa sipas Regjistrisë Civile banojnë 757,361 banorë. Me një sipërfaqe prej 1,110.03 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit është 502 banorë/ km², ndërsa sipas Regjistrisë Civile, densiteti është 682 banorë km².

4.5. Ekologjia

Ne zonen ne fjale ku do ndertohet objekti nuk ka flore dhe faune, pasi siperfaqja ku do ndertohet eshte zone urbane e gjitha e ndertuar. Nuk ka hapësira te gjelberta,si pasoje edhe faun nuk ka. Te vetmet bime qe ekzistojne jane ato dekorative qe jane mbjelle nga bashkia Tirane ne trotualet e rrugëve kryesore.

4.6. Gjeologjia dhe hidrogeologjia

Tirana shtrihet mbi shtresëzime dhe xhepa kuaternari. Ato janë shtresëzime aluviale përgjatë rrjedhës së dy lumenjve kryesorë. Disa brezare më të vjetra lumore janë të përbëra nga zhavorr, gurë ranor e baltë argjilore. Tirana shtrihet në një shtresë ujë-mbajtëse me përmbajtje poroze, që është pjesërisht arteziane. Uji i nëndheshëm gjendet kryesisht në pjesën perëndimore të qytetit dhe përdoret si për furnizimin publik me ujë dhe për përdorime private, veçanërisht për industrinë.

Puset janë mjaft të cekët, rreth 15 metra të thellë, gjë që i ekspozon ato më shumë ndaj ndotjes nga aktivitetet në sipërfaqe.


Të territorin e Tiranës gjenden disa vendburime qymyrguri të pashfrytëzuara, ndërsa aktiviteti më i përhapur sa i përket shfrytëzimit të burimeve natyrore është përpunimi i gurit për ndërtim dhe atij dekorativ.

4.7. Ekonomia

Tirana është qendra më e rëndësishme industriale në Shqipëri. Për tu përmendur janë industria e lehtë dhe ushqimore si dhe industria ndërtimore, por edhe industria e ndërtimit të makinerive apo ajo e tekstilëve dhe e përpunimit të qelqit. Si në të gjithë vendin ashtu edhe kryeqyteti i Shqipërisë ndodhet në një periudhë tranzicioni. Pas rrëzimit të diktaturës komuniste shumë vepra të dikurshme industriale kanë dalë pjesërisht jashtë përdorimit dhe nuk funksionojnë rregullisht. Por ndërkohë po merren masa të shpejta për rimëkëmbjen dhe vënjen sa më të shpejtë në punë të veprave ekzistuese dhe të reja. Shumica e popullsisë janë sot të punësuar në sektorin e tregtisë dhe atë të ndërtimit, në sektorin e shërbimeve publike, atë turistik dhe si punonjës të shtetit.

4.8. Klima

Në Tiranë mbizotëron një klimë nëntropikale-mesdhetare me rreshje dimërore dhe me temperatura mesatare vjetore në korrik + 24° Celsius dhe në janar +7° Celsius. Në vit bie 1 189 mm shi.



Burimi BBC Weather Service

4.9. Sizmiciteti

Trualli Shqiptar vendoset gjate kufirit te perplasjes se dy pllakave te medha qe levizin njera kunder tjetres; pllakes Euroaziatike dhe asaj Arabo-afrikane, dhe eshte vater e perqendruar termetesh e cila preket me shpesh nga termete demtues. Tirana si shume zona te tjera te vendit eshte zone e prekur nga termetet, ku nga pikepamja sizmoteknike zona mund te goditet nga termete me magnitudo $M_{max}=5.5-6.0$ grade Richter me intensitet deri ne 7 balle MKS-64 e cila shkakton çarje ne mur dhe rrezim te copave te suvash por per objektet e uleta nuk parashikohen shqetesime. Si dhe mundesite per te goditur termetet me shume balle jane te vogla rreth 20%.

4.10. Gjeologjia dhe Dherat

Shqiperia si formacion gjeologjik eshte pjese perberese e rrudhosjeve alpino-mesdhetare pjese e degezimit Dinaro-albano-Helenid, ku ne bejme pjese tek Albanidet. Tirana si zone e jashtme ben pjese ne Ultesiren Paramalore, dhe ndodhet ne krahinen e ultesires perendimore dhe karakterizohet nga shkembinj te dobet qe i ben te paqendrueshem nga rreshqitja dhe eshte pjese e sistemit neogjenik argjila, konglomerat ranor.

5 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË RËNDËSISHME NË MJEDIS

5.1 Metodika e përdorur për vlerësimin e ndikimeve të mundshme në mjedis

Çdo aktivitet që zhvillohet në mjedis shoqërohet me pasoja dhe ndikime në të, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jonë ka zgjedhur për t’u zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe më analitikiisht ndikimet e çdo operacioni të kryer. Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasojë e veprimtarisë bëhet duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur për ndërtim, mënyrën e funksionimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha këto në kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Bazuar në llojin e projektit të propozuar ndikimet më thelbësore mund dhe duhet të analizohen sipas dy fazave të veprimtarisë:

- në fazën e ndërtimit të Objekteve
- në fazën e funksionimit

Është e rëndësishme të kuptohet natyra e këtyre proceseve dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte ose indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve. Duke analizuar edhe shtrirjen në kohë të këtyre ndikimeve, ato klasifikohen në:

- Ndikime të kthyeshme në mjedis
- Ndikime të pakthyeshme në mjedis

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizim e proceseve të natyrës dhe rigjenerim të ekosistemit.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtme:

- njohja me projektin dhe fazat e zbatimit të tij,
- njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis,
- njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes,
- konsultimi me dokumente ligjorë e administrativë dhe raporte të VNM për veprimtari të njëjta.

5.2 Vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve të identifikuar

Për të përcaktuar më mirë masat për kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve negative të identifikuar gjatë procesit të VNM-se dhe për të ndihmuar vendimmarrjen e organeve kompetente, në këtë paragraf është bërë një kategorizim i rëndësisë së çdo ndikimi të mundshëm negativ në mjedis të projektit. Ky kategorizim është kryer bazuar në vlerat mjedisore të zonës, legjislacionin mjedisor në fuqi dhe njohuritë mbi teknologjinë dhe teknikën e kryerjes së operacioneve ndërtimore.

Metodika e vlerësimit të rëndësisë së ndikimeve të mundshme negative në mjedis:

Kategoria	Përshkrimi
I ulët	Ndikimi është i përkohshëm, dëmton pak vlera natyrore si në cilësi dhe në sasi (volume). Me përfundimin e operacionit që e shkakton ai nuk jep më efekte në mjedis.

I mesëm	Ndikimi është i përkohshëm por në mungesë të masave kontrolluese dhe menaxhuese mund të shkaktojë ndikime afatgjata në vlerat natyrore. Sipërfaqja që tjetërsohet nuk rikthehet më në gjendjen e saj por zë një raport të pranueshëm me sipërfaqen totale të zonës (koeficienti i tjetërsimit) si dhe tjetërsohet vetëm sipërfaqja ndërtimore e objektit. Ndikimi nuk përfaqëson shkarkime të ndotësve në mjedis
I konsiderueshëm	Ndikimi është i përhershëm dhe del përtej zonës së ndikuar (zhvendosje, ndotje, zhurma e shkarkime në ajër). Ndikimi kompromenton normat e shkarkimeve në mjedis dhe normat e përdorimit të mjedisit
I kthyeshëm	Mbaron efektin me ndalimin e shkakut dhe mjedisi i ndikuar rifiton gjendjen e tij natyrale. Dëmton vlera/zona të mbrojtura dhe unikale.
I pakthyeshëm	Pasojat e ndikimit janë të pakthyeshme (vazhdojnë efektin negativ në mjedis) edhe pasi përfundon veprimi që shkakton ndikimin

5.3 Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis

Për të paraqitur ndikimet e mundshme të identifikuar që përkojnë me fazat e realizimit të projektit, do të përdoren strukturat tabelare. Në planin vertikal tabelat do të përshkruajnë operacionet e punës sipas fazave të projektit, ndërsa në atë horizontal do të jepet përshkrimi i pasojave të operacionit përkatës në receptorët e mjedisit.

5.4 5.3.1 Identifikimi i ndikimeve të mundshme në fazën e ndërtimit

Ndikimet e mundshme negative në tokë	
Operacioni që kryhet në mjedis	Pasojat në mjedis
Prishja e objekteve egzistuese	Si pasojë e operacioneve për prishjen e objekteve egzistuese në zonën në studim do të gjenerohet një sasi e konsiderueshme mbetjesh inerte të cilat mund të shkaktojnë prishje të strukturës së tokës.
Gërmim i tokës dhe përshtatje e sipërfaqes për ndërtim	Si pasojë e operacioneve ndërtimore dhe përshtatjes së zonës të ndërtimit do të realizohen punime gërmuese për hapjen e themeleve, si pasojë e të cilave: do të gjenerohet një sasi e konsiderueshme dherash dhe mbetjesh inerte. Prishje të strukturës së tokës, do të kemi dëmtim të mundshëm të proceseve tokësore të drenazhimit.
Lëvizja e automjeteve të transportit dhe përdorimi i makinerive në procesin e ndërtimit	Si pasojë e lëvizjes së makinerive: do të kemi ngjeshje të tokës në sektorë të veçantë të saj, mund të kemi rrjedhje aksidentale të lubrifikantëve nga ndonjë avari me pasojë ndotje të tokës.
Magazinim i lëndëve të para dhe parkim i automjeteve	Si rezultat i përshtatjes së sipërfaqeve të caktuara për parkimin e mjeteve të punës dhe magazinimin e lëndëve të para.

NDIKIMET E MUNDSHME NEGATIVE NË UJË	
Operacioni që kryhet në mjedis	Pasoja në mjedis
Gërmim i tokës dhe përshtatja e sipërfaqes për ndërtim	Këto dy operacione do të shoqërohen me gjenerim të një sasive të konsiderueshme dherash. Nëse nuk merren masat e nevojshme për sistemimin e tyre në vendet dhe mënyrën e duhur, nën ndikimin e agjentëve atmosferikë, ata mund të depërtojnë në trupat ujorë të zonës duke ndikuar si në nivelin e ujrave ashtu edhe në cilësinë e tyre. Njëkohësisht kjo sasi dherash mund të bëhet shkak për ndryshimin e rrjedhave stinore sipërfaqësore të ujrave të shiut.
Prishja e objekteve egzistuese	Këto operacione do të shoqërohen me gjenerim të një sasive të konsiderueshme dherash. Nëse nuk merren masat e nevojshme për sistemimin e tyre në vendet dhe mënyrën e duhur, nën ndikimin e agjentëve atmosferikë, ata mund të depërtojnë në trupat ujorë të zonës duke ndikuar si në nivelin e ujrave ashtu edhe në cilësinë e tyre.
Lëvizja e automjeteve të transportit dhe përdorimi i makinerive në procesin e ndërtimit	Si pasojë e qarkullimit të mjeteve dhe përdorimit të mekanikës mund të kemi rrjedhje aksidentale të lubrifikantëve nga ndonjë avari e mundshme me pasojë ndotje të ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
Magazininim i lëndëve të para dhe parkim i automjeteve	Rrjedhje vajrash dhe lubrifikantësh nga automjetet e parkuar depozitim i mbetjeve nga materialet në trupat ujorë të zonës.

NDIKIMET E MUNDSHME NEGATIVE NË BIODIVERSITET/PEJSAZH	
Operacioni që kryhet në mjedis	Pasoja në mjedis
Gërmim i tokës dhe përshtatja e sipërfaqes për ndërtim	Punimet e gërmimit dhe përshtatjes së sipërfaqes për ndërtim do të shoqërohen: modifikim të peisazhit ekzistues (ndikim minimal). Për të minimizuar këto ndikime, në projekt është parashikuar ndërtim i objektit në forme sa më relaksues dhe jo agresive, të cilat përputhen në mënyrë harmonike me natyrën dhe karakterin e ndërtimit të kësaj zone.
Prishja e objekteve egzistuese	Si pasojë e operacioneve për prishjen e objekteve egzistuese në zonën në studim: Do të kemi ndryshim të peisazhit ekzistues.

NDIKIMET E MUNDSHME NEGATIVE NË AJËR	
Operacioni që kryhet në mjedis	Pasoja në mjedis
Gërmim i tokës dhe përshtatja e sipërfaqes së tokës për ndërtim	Si pasojë e punimeve të gërmimit dhe operacioneve ndërtimore: do të gjenerohet një sasi pluhuri, do të evidentohen emetime të zhurmave dhe vibrime.
Lëvizja e automjeteve të transportit dhe përdorimi i makinerive në	Si pasojë e lëvizjes së automjeteve do të gjenerohen: zhurma,

“STRUKTURË BANIMI DHE SHËRBIME 1, 6 & 9 KATE ME 2 KATE NËNTOKË PARKIM”

procesin e ndërtimit	pluhur, gaze nga djegia e karburantit të motorëve.
Prishja e objekteve egzistuese	Si pasojë e operacioneve për prishjen e objekteve egzistuese në zonën në studim: do të gjenerohet një sasi pluhuri, emetime të zhurmave dhe vibrime

NDIKIMET E MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDISIN SOCIAL-EKONOMIK	
Operacioni që kryhet në mjedis	Pasoja në mjedis
Aktivitetet e zhurmshme gjatë natës	Aktivitetet e zhurmshme gjatë natës shndërrohen në një problem social në këtë zonë, duke rritur nivelin e stresit të banorët, për shkak të zhurmave.
Nevoja për ambiente social-kulturore	Nevoja për ambiente të reja social-kulturore si shkolla, kopshte, ambiente argëtimi, qendra shëndetësore, qendra kulturore të cilat duhet të merren në konsideratë gjatë projektimit të objekteve të reja.
Rëndimi i trafikut	Pavarësisht faktit se zona ku do të kryhen ndërtime kufizohet me një rrugë dytësore, gjatë fazës së ndërtimit parashikohet një rëndim i trafikut në zonën përreth për shkak të lëvizjes së automjeteve të tonazhit të rëndë, duke shkaktuar kështu stres tek banorët përreth dhe rritje shpenzimi për lëndën djegëse të automjeteve.

Emetimet e zhurmave dhe gazeve të kamionëve në mjedis

Sa lidhet me emetimin e zhurmave gjatë fazës ndërtimore, duhet theksuar se ky ndikim është i përkohshëm. Së pari faza e ndërtimit është një fazë e mirëpërcaktuar në kohë dhe së dyti operacionet e ndërtimit do të kryhen brenda orareve të zakonshëm të punës. Bazuar edhe në referencat ndërkombëtare për projekte të ngjashme vlerësohet se zhurmat teknologjike nga mjetet e rënda e japin efektin e tyre akumulativ deri në një rreze prej 150 - 200 m në varësi edhe të konfiguracionit natyror të terrenit i cili luan rolin e një barriere natyrale etj. Për rrjedhojë pritet që qendrat e banuara më të afërta të ndikohen negativisht nga zhurmat e pajisjeve të rënda si buldozerë, eskavatorë, kamionë etj. Sipas natyrës së projektit të propozuar, mjetet më të përdorshëm në fazën e ndërtimit janë kamionët dhe fadromat, vlerat e emetimit të zhurmave të cilëve jepen në tabelën e mëposhtme.

Pajisja	Vlerat
Kamion	81 – 87 Leq dB (A) ne 15 m
Fadromë	76- 78 Leq (dB(A) ne 15 m

Ndërkohë Udhëzimi nr.8 datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”, përcakton vlerat e lejuara të zhurmës si në tabelën e mëposhtme:

Nivelet kufi të zhurmës në mjedise të caktuara

Mjedisi	Efekti kritik në shëndet	LAeq (dBA)	Koha bazë (orë)	LMax Fast (dB)
Zona banimi				

“STRUKTURË BANIMI DHE SHËRBIME 1, 6 & 9 KATE ME 2 KATE NËNTOKË PARKIM”

Jashtë banese	Bezdi (shqetësim) serioze gjatë ditës dhe mbrëmjes	55	16	-
	Bezdi (shqetësim) i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	50	16	-
Në brendësi të banesave	Kuptueshmëri e bisedës dhe (bezdi) shqetësim i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	35	16	-
Në brendësi të dhomës së fjetjes	Prishja e gjumit natën	30	8	-
Jashtë dhomës së fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera nga jashtë)	45	8	-
Zona me aktivitetet social-ekonomik				
Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110
Mjedis urban				
Mjedise publike, të jashtme apo të brendshme	Dëmtim dëgjimi	85	1	110

Shpjegime:

L_{Aeq} (dBA) = Niveli ekuivalent i matur në shkallën A

Koha baze (ore) = Koha gjatë së cilës bëhet matja

L_{Amax} Fast (dB) = Niveli i matur në shkallën A në mënyrën Fast (e shpejtë)

1 = Sa më e ulët që të jetë e mundur

2 = Presioni zanor maksimal (L_{Amax}, fast) matur 100 mm larg veshit

3 = Zonat e jashtme të qeta duhet të mbrohen dhe raporti i zhurmës hyrëse/shtesë me zhurmën e fonit natyral duhet të ruhet sa më i ulët që të jetë e mundur

4 = Nën kufjet e dëgjimit, përshtatur me vlerat e fushës së lirë

Nga krahasimi i nivelit të zhurmave që çlirojnë mjetet e punës me ato kufi të lejuara vërehet se nivelet e lejuara të zhurmave në qendrat e banuara më të afërta gjatë kohës së zbatimit të projektit mund të tejkalohen. Për këtë arsye, është e nevojshme që firma që do të zbatojë projektin të punojë me efikasitet për të mënjanuar orët e tejzgjatura të punës dhe duke mënjanuar punimet në orët e para të mëngjesit ose në mbrëmje. I njëjti arsyetim vlen edhe për sasinë e gazeve dhe pluhurave që do të emetohen si pasojë e djegies së karburantit në motorë dhe lëvizja e automjeteve.

Faktorët e shkarkimit për kamionat që punojnë me naftë (3.5 – 16 t)

Lloji i emetimeve	NOx	CH2	VOC	CO	N2O	CO2	Grimcat
Total g/km	10.9	0.06	2.08	8.71	0.03	800	19.16
Siç vërehet më lart, shkarkimet ditore nga trafiku rrugor, duke marrë 3 km rrugë për çdo kamion/ditë në zonën që na intereson do të jenë:							
NOx = 30 km x 10.9 g/km = 0.0003 t/d				Këto vlera janë të vogla për të patur ndonjë efekt negativ mbi popullatën dhe mjedisin e zonës.			
CH2 = 30 km x 0.06 g/km = 0.000002 t/d							
VOC = 30 km x 2.08 g/km = 0.0008 t/day							
CO = 30 km x 8.71 g/km = 0.0003 t/d							
N2O = 30 km x 0.03 g/km = 0.000001 t/d							

Ref EPA (USA) - Atmospheric Emission Inventory Guidebook, CORINAIR, 1996

Prodhimi i dherave dhe mbetjeve nga veprimtaria ndërtimore

Gjatë operacioneve të përshtatjes së sipërfaqes së ndërtimit dhe hapjes së themeleve do të gjenerohet sasi dherash. Kjo sasi dheu klasifikohet si mbetje ndërtimore nëse lind nevoja të depozitohet apo zhvendoset nga zona në një sipërfaqe tjetër. Shoqëria që do të zbatojë projektin duhet të planifikojë qartë mënyrën e administrimit të dherave për të mënjanuar mundësinë e depozitimit të tyre përgjatë brigjeve të përrenjeve dhe bregut të detit. Shoqëria do t'i transportojë këto dhera në periferi të qytetit, në zona të përcaktuara paraprakisht nga Bashkia e Tiranës.

6 MASAT PËR PARANDALIMIN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NË MJEDIS

Plani i zbutjes së ndikimeve mjedisore ka për qëllim parandalimin ose minimizimin e ndotjes dhe dëmtimit të mjedisit. Ai synon respektimin e standardeve mjedisore gjatë kryerjes së aktiviteteve ndërtuese të objektit dhe më pas shfrytëzimin e saj, në mënyrë të sigurt dhe efektive, me qëllim final mbrojtjen e mjedisit.

Në vështrim të përgjithshëm masat zbutëse të ndikimeve në mjedis klasifikohen në:

- masa teknike,
- masa organizative.

Masat teknike synojnë përshtatjen e projektit me vlerat natyrore të zonës me qëllim mbrojtjen në maksimum të tyre. Masat organizative përfaqësojnë të gjitha veprimet që duhet të ndërmarrin ushtruesit e veprimtarisë (përfshirë zbatuesin e projektit në fazën e ndërtimit të objektit) për mbrojtjen e vlerave natyrore të zonës dhe rritjen e performancës mjedisore të aktivitetit. Këtu përfshihet edhe hartimi i planit të menaxhimit mjedisor.

Plani i masave zbutëse fokusohet në identifikimin e ndikimeve në mjedis në fazat e ndërtimit të objektit dhe funksionimit të saj, masat përkatëse mënjanoese ose minimizuese si dhe institucionet përgjegjëse.

6.1 Plani i masave zbutëse të ndikimeve në fazën e ndërtimit të objektit

Toka	
Si pasojë e përshtatjes së sheshit të ndërtimit dhe punimeve të gërmimit për hapjen e themeleve për ndërtimin e objektit do të gjenerohet një sasi e konsiderueshme dherash.	Përpara fillimit të punimeve duhen kryer piketime të sakta të sipërfaqes. Masat e dherave që do të gjenerohen do të sistemohen fillimisht brenda sipërfaqes së ndërtimit dhe më pas do të depozitohen në vendin e përcaktuar paraprakisht nga Bashkia Tiranë. Një pjesë do të ruhet për qëllime mbushje (në varësi të karakteristikave fizike të dherave) gjatë krijimit të sipërfaqeve të gjelbëruara.
Si pasojë e punimeve të ndërtimit do të kemi prishje të strukturës së tokës dhe nxitje të proceseve të erozionit.	Përpara fillimit të punimeve duhen kryer piketime të sakta të sipërfaqes për të mënjeluar dëmtimin e sipërfaqeve të panevojshme. Njëkohësisht stafi që do të kryejë këto operacione pune duhet të trajnohet për mbrojtjen e mjedisit dhe vlerave natyrore të zonës gjatë kryerjes së punimeve.
Dëmtim i mundshëm i proceseve natyrore të drenazhimit.	Gjatë stinës së thatë duhet të bëhet modeli dhe ndërtimi i sistemit të drenazhimit dhe kullimit të ujrave sipërfaqësorë dhe të reshjeve, për të evituar rrezikun e përmytjeve gjatë stinës së lagësht. Kanalet e kullimit duhet të mbillen me bar anëve me qëllim që të pengohet procesi i gërryerjes së tyre gjatë transportit të ujërave sipërfaqësorë.
Prishja e objekteve egzistuese	Përpara fillimit të punimeve duhen kryer piketime të sakta të sipërfaqes. Masat e dherave që do të gjenerohen do të depozitohen në vendin e përcaktuar paraprakisht nga Bashkia Tiranë. Largimi i dherave do të kryhet në oraret e përcaktuara nga Bashkia Tiranë, me mjete të tonazhit të rëndë. Një pjesë e dherave do të ruhet për

	qëllime mbushje (në varësi të karakteristikave fizike të dherave) gjatë krijimit të sipërfaqeve të gjelbëruara dhe të të gjitha pjesëve e gërmuara si kanale, gropa dhe pjesë të rrezikshme të hapura në tokë. Objekti do të rrethohet me skeleri dhe do të vishet me rrjetë mbrojtëse deri në momentin e perfundimit të punimeve.
Si pasojë e punimeve të ndërtimit dhe lëvizjes së makinerive do të kemi ngjeshje të tokës.	Për të limituar sipërfaqen që do të ngjishet do të përcaktohen saktësisht vendet e qëndrimit të mjeteve të rënda dhe do të kontrollohet lëvizja e tyre për të mënjeluar qarkullimin e panevojshëm dhe për të minimizuar trafikun në zonë.
Ndotje e mundshme e tokës nga derdhja aksidentale e lëndëve ndotëse që përdoren gjatë ndërtimit apo nga karburantët dhe lubrifikantët e tjerë që përdorin automjetet e transportit dhe mjetet e rënda të punës.	Të gjitha automjetet dhe mjetet e punës që përdorin lubrifikantë të çdo lloji do t’i nënshtrohen kontrolleve periodikë mbi gjendjen e tyre teknike. Të gjitha pjesët që mund të rezultojnë të dëmtuara dhe burim rrjedhjesh do të riparohen menjëherë. Në raste të rrjedhjeve aksidentale, do të bëhet pastrimi i menjëhershëm i vendit duke e larguar pjesën e ndotur të tokës (dherave), e cila do të depozitohet në fuçi të posaçme plastike ose metalike, me kapak, në pritje për trajtim të mëtejshëm.
Uji	
Si pasojë e qarkullimit të mjeteve dhe përdorimit të mekanikës mund të kemi rrrjedhje aksidentale të lubrifikantëve nga ndonjë avari me pasojë ndotje të ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.	Të gjitha automjetet dhe mjetet e punës që përdorin lubrifikantë të çdo lloji do t’i nënshtrohen kontrolleve periodikë mbi gjendjen e tyre teknike. Të gjitha pjesët që mund të rezultojnë të dëmtuara dhe burim rrjedhjesh do të riparohen menjëherë. Në raste të rrjedhjeve aksidentale, do të bëhet pastrimi i menjëhershëm i vendit duke e larguar pjesën e ndotur të tokës (dherave), për të mos lejuar depërtimin e ndotjes në ujërat sipërfaqësorë dhe nivelin e ujit nëntokësor të zonës.
Dherat e gjeneruar nga punimet e gërmimit nën ndikimin e agjentëve atmosferikë mund të depërtojnë në trupat ujorë të zonës duke ndikuar si në nivelin e ujrave ashtu edhe në cilësinë e tyre. Njëkohësisht kjo sasi dherash mund të bëhet shkak për ndryshimin e rrjedhave stinore sipërfaqësore të ujrave të shiut.	Masat e dherave që do të gjenerohen do të dergohet direkt në vendet e përcaktuara nga Bashkia Tiranë. Pasi në sipërfaqen ku do ndertohet objekti nuk ka ambjenete të lira për të depozituar përkohësisht sasi të dherave të gjeneruar. Për të mënjeluar rrezikun e shpërndarjes së grimcave nën veprimin e agjentëve atmosferikë si era dhe shiu, masat e dheut do të mbulohen.
Depozitim i mbetjeve të tjera të ngurta të gjeneruara nga aktiviteti ndërtues dhe njerëzor.	Në të gjithë sipërfaqen e kantierit do të vendosen kontenerë të posaçëm për mbetjet e ngurta. Depozitimi i mëtejshëm i tyre do të bëhet në vendet e caktuar që më parë në marrëveshje me pushtetin vendor.
Ajri	

<p>Emetim pluhurash si pasojë e punimeve të gërmimit, operacioneve të ndërtimit dhe transportit.</p>	<p>Lagje e zones së kantierit ku kryhen këto lloj operacionesh për të ulur sasinë e pluhurit. Do të merren masa për mbulimin e masave të dherave në venddepozitim të tyre. Gjithashtu do të mbulohen edhe kamionët që i transportojnë këto dhera dhe materialet e tjerë të ndërtimit. Mjetet e transportit do të pastrohen para daljes jashtë kantierit.</p>
<p>Emetim gazesh dhe aromash nga automjetet e transportit dhe mjetet e rënda të punës.</p>	<p>Planifikim i saktë i kohëzgjatjes së punimeve në terren për të mënjeluar tejzgjatjen e panevojshme të tyre. Të gjitha automjetet dhe mjetet e punës do t'i nënshtrohen kontrolleve periodikë në lidhje me gjendjen teknike të tyre. Njëkohësisht rëndësi do i kushtohet cilësisë së lëndëve djegëse që do të përdoren.</p>
<p>Emetim zhurmash dhe vibracionesh.</p>	<p>Do të parashikohet me saktësi koha e nevojshme e punës së mjeteve në mënyrë që motorët të mos qëndrojnë ndezur gjatë në mënyrë të panevojshme. Njëkohësisht të gjitha mjetet e punës do të kontrollohen periodikisht në lidhje me gjendjen e tyre teknike, veçanërisht për guarnicionet në mënyrë që zhurmat të mos i kalojnë nivelet e lejuara teknologjike. Operacionet e punës do të kryhen në orët normale të punës, duke marrë parasysh faktin që zona në studim ndodhet në zone të banuar.</p>
<p>Rendimi i trafikut</p>	<p>Gjatë fazës së ndërtimit të objektit, egziston mundësia që trafiku në zonë të rëndohet dhe si rrjedhim do të kemi gjenerim të gazeve që çlirohen nga motorët e makinave dhe gjenerim zhurmash. Për të shmangur këtë, firma do të marrë masat që automjetet e rënda të lëvizin në orare ku trafiku nuk është i rënduar.</p>
<p>Biodiversiteti, Pejshazi</p>	
<p>Prerje drurësh dhe shkurresh gjatë procesit të përgatitjes së sipërfaqes së ndërtimit</p>	<p>Përpara fillimit të punimeve dhe gjatë gjithë fazës së zhvillimit të tyre duhet vepruar në zbatim të përpiktë të projektit për të mënjeluar dëmtimin e individëve që nuk e pengojnë ndërtimin. Zona ku do të ndërhyet për punime është e zhveshur nga bimësia. Në projekt është parashikuar një sipërfaqe me bimësi urbane (pemë dekorative, gjelberim me bimësi barishtore etj).</p>
<p>Modifikim i peisazhit egzistues</p>	<p>I gjithë projekti është konceptuar për ndërtimin e strukturës. Ndërtimi i këtij objekti do të jap një tjetër peisazh zonës, por më të bukur dhe më estetik.</p>
<p>MJEDISI SOCIAL-EKONOMIK</p>	
<p>Siguria në Rrugë dhe Kontrolli i Trafikut</p>	<p>Subjekti nuk duhet të ndërmarrë asnjë veprim në rrugë publike apo në afërsi të tyre pa njoftuar në fillim Supervizorin e objektit dhe pa marrë miratimin e tij më pas për të vepruar. Për të marrë miratim ai duhet të deklarojë qartë detajet e shenjave dhe masave për kontrollin e trafikut që propozon të përdorë si dhe datat dhe oraret gjatë të cilave do të punojë në rrugë publike apo afër tyre. Gjatë</p>

“STRUKTURË BANIMI DHE SHËRBIME 1, 6 & 9 KATE ME 2 KATE NËNTOKË PARKIM”

	<p>punimeve të tij ai duhet të sigurojë se rruga publike do të mbetet e hapur dhe e gatshme për përdorim si dhe në gjendje të mirë dhe se vonesat në trafik do të minimizohen.</p>
Aktivitetet e zhurmshme gjatë natës	<p>Aktivitetet e zhurmshme gjatë natës do të jenë të reduktuara dhe brenda normave të lejuara sipas legjislacionit shqiptar duke shmangur kështu një problem social në këtë zonë, i cili rrit nivelin e stresit të banorët.</p>
Nevoja për ambiente social-kulturore	<p>Në projekt është parashikuar një sipërfaqe me bimësi urbane (pemë dekorative, gjelberim me bimësi barishtore etj) e cila do t’iu japë banorëve një mjedis relaksues.</p> <p>Projekti gjithashtu i jep zgjidhje problemit të parkimit duke parashikuar 2 kate parkim nëntokë.</p>

7 PROGRAMI MONITORIMIT

7.1. Skema e monitorimit të treguesve mjedisor.

Pjesë e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është edhe Plani i Monitorimit Mjedisor (PMM). Monitorimi do të fokusohet në mbledhjen e të dhënave për të verifikuar parashikimet e ndikimeve dhe efektshmërinë e masave zbutëse të planifikuara.

PMM përcakton gjithashtu mënyrat si do të kryhet monitorimi i ndikimeve mjedisore dhe zbatimi i masave zbutëse gjatë fazës së punimeve. Vëmendja kryesore do të drejtohet në rishikimin e të gjithë propozimeve për punime të reja me ndikim potencial në mjedis për të siguruar zbatimin e tyre në përputhje me normat mbi mbrojtjen e mjedisit.

Monitorimi mjedisor, i cili do të realizohet nga një staf i specializuar, konsiston në:

- *Mbikëqyrje afatgjatë* të cilësisë së përgjithshme mjedisore, të kryer në një periudhë afatgjatë dhe mbi një zonë më të madhe se zona e projektit për të vlerësuar efektet që ndodhin edhe pas përfundimit të projektit .
- *Mbikëqyrje specifike të vendit*, afatmesme, të kryer së pari për të parë nëse parashikimi i vlerësimit të ndikimit mjedisor të projektit është i saktë apo jo (pamje ajrore nga lart, depozitim/erozion në vendet e paracaktuara, sedimentet e mbetura pezull në kolonën e ujit, cilësia e ujit për larje);
- *Mbikëqyrje të përputhshmërisë operacionale* afatshkurtër të treguesve të proceseve të zgjedhura operacionale që do të përdoren çdo ditë gjatë ekzekutimit të punimeve, të tilla si turbullimi gjatë operacioneve të thellimit, prodhim pluhuri e zhurme.

Mbikëqyrja do të zbatohet sipas një plani të detajuar veprimtarish.

Sipas fazave të projektit duhet të hartohet një program monitorimi me indikatorët përkatës që të tregojnë për presionin që po ushtrojnë në mjedis aktivitetet e zbatimit të projektit. Në fazën e ndërtimit duhet t’i kushtohet rëndësi vërtetimit të ndikimeve të parashikuara mjedisore të projektit si dhe atyre të paparashikuara me qëllim që të adaptohen masa të menjëhershme zbutëse ndaj pasojave të tyre.

Parametrat që do të monitorohen sipas fazave të projektit jepen në tabelën më poshtë:

Faza ndërtimore			
1	Aksidentet teknike me pasoja në mjedis, rrjedhje karburantesh etj.	Sipas rastit/ dokumentim	Zbatuesi i projektit
2	Dokumentimi i ndotjeve aksidentale në trupa ujorë	Sipas rastit/ dokumentim	Zbatuesi i projektit
3	Sasia e mbetjeve inerte që do të gjenerohen nga hapja e themeleve	Gjatë fazës së gërmimit për përgatitjen e sheshit dhe hapjes së themeleve për objektit/dokumentim	Zbatuesi i projektit
4	Pluhuri dhe zhurmat gjate procesit te ndertimit.	Vrojtim dhe matje të zhurmave gjatë fazës ndërtimore/dokumentim	Zbatuesi i projektit
5	Punimet për krijimin e hapsirave të gjelbërta (llojet dhe numri i pemëve sipas planifikimeve në projektin teknik)	Në fazën përkatëse/dokumentim	Zbatuesi i projektit

8 KONKLUSIONE

Ndikimet e mundshme negative në mjedis

Nga analiza e ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit sipas fazave të zbatimit të tij, por edhe nga plani i masave zbutëse, del qartë se disa nga ndikimet kanë karakter të pakthyeshem. Si të tillë do të veçonim tjetërsimin e sipërfaqes, si dhe modifikimin e pejsazhit. Por, ndonëse të gjitha këto ndikime konsiderohen ndryshe si humbje e vlerave natyrore të zonës, nuk duhen konsideruar si faktorë pengues për zhvillimin e projektit. Në analizë përfundimtare, projekti i propozuar është në përputhje të plotë me planet e zhvillimit të zonës. Ndërtimi i këtij objekti nuk ndikon në florë dhe faun pasi në këtë zonë nuk ka florë dhe faun të zhvilluar.

Ndikimet e tjera, të cilësuar si të një kategorie më të ulët dhe të kthyeshme, nuk përfaqësojnë humbje të konsiderueshme të burimeve dhe vlerave natyrore. Të tilla janë emetimet e pluhurave, gazeve apo zhurmave gjatë fazës së ndërtimit të objektit i cili ka aftësi vepruese të limituar në kohë. Gjithsesi, ndonëse këto janë ndikime të përkohshme dhe të një shkalle më të ulët, zbatuesi i projektit është i detyruar të zbatojë planin e masave zbutëse për to.

Përparësitë e projektit

- Projekti është në përputhje me planin e zhvillimit të zonës.
- Sipërfaqja ku do të zbatohet projekti nuk karakterizohet nga bimësi e dendur dhe e lartë, është një sipërfaqe me pak bimësi të zhveshur dhe projekti parashikon sipërfaqe me bimësi dekorative.
- Projekti i jep zgjidhje problemit të parkimit, duke parashikuar 2 katen nëntokë parkim.
- Zona është e identifikuar si zonë me zhvillim banimi dhe shërbime publike.
- Zona në studim ndodhet brenda vijës së verdhë të qytetit.
- Në projekt parashikohen masa për mbrojtjen e mjedisit.
- Projekti vetë është i konceptuar në harmoni me vlerat natyrore të zonës dhe do ti jape nje peisazh të ri estetik zonës.

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	K81317002P	
2. Data e Regjistrimit	17/01/2008	
3. Emri i Subjektit	ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	15/01/2008	
6. Kohëzgjatja	Nga: 15/01/2008 Deri:	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajës, Pallati Baja Bad, përbri Qendres Tregtare Globe, Kati 11	
8. Kapitali	63.000.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00	
9. Objekti i aktivitetit	Ne fushen e mjedisit: Vleresimi i ndikimit ne mjedis, ekspertize dhe auditim mjedisor, plan menaxhimi dhe plan rehabilitimi mjedisor, raportim zbatimi te kushteve te mjedisit, studime fizibiliteti ne fushen e menaxhimit te mbetjeve, menaxhim projektesh, konsulence teknike dhe ligjore per ceshtje lidhur me mjedisin. Ne fushen e pasurive te paluajtshme: Vleresim te pasurive te paluajtshme, vleresim asetesh, ekspertize, studim tregu imobiliar, konsulence teknike dhe ligjore ne fushen e pasurive te paluajtshme. Ne fushen e projektimit dhe ndertimit: supervizion dhe kolaudim punimesh per objekte ndertimi, projektim arkitektonik te objekteve te banimit dhe objekte shoqeror, interior/eksterier, planifikim urban, mbikqyrje dhe kolaudim punimesh per objekte ndertimi.	
10. Administratori/ët	Elidiana Shehu	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 16/06/2011	Deri: 25/05/2021
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Elidiana Shehu	



REPUBLIKA E ALBANIËS
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES



Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

12.1 Vlera e kapitalit	Para: 63.000.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	100,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS Telefon: 0692076779 Të Tjera: Depozitim i vendimit nr.1 date 08.06.2010 ku caktohet si ekspert kontabel i regjistruar për rritjen e kapitalit Znj.Lumturije Brahaj me liçense nr.121.	
15. Statusi:	Aktiv	

Datë: 14-10-2016


Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



DHOMA E NOTERISË TIRANË

Notere: Albana B.Skana

Nr. 2857 Rep.

albanaskana@yahoo.com 00355 672021400

VËRTETIM

(i njësisë së kopjes me originalin)

Sot,më datën 23.09.2016 përpara meje Noteres Albana B.Skana,Notere e Dhomës së Noterëve Tiranë,me adresë Rr. « Teodor Keko », (Unaza e Re), Yzberish, u paraqit personalisht shtetasja :

Shoqëria « **Environmental Management Consultants** » shpk me NIPT -K81317002P me përfaqësues ligjor , Znj.**Elidiana Shehu** , atësia Bujar, e datëlindjes 15.05.1979, lindur në Tepelënë banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,identifikuar me dokumentin ID Nr. H95515079H , e cila kërkoi vërtetimin e njësisë me originalin të kopjes së dokumentit si më poshtë :

- **Licencë** nga **QKL** nr.LN-7282-01-2014 lëshuar më dt.14.01.2014 në emër të Shoqërise « Environmental Management Consultants » shpk me NIPT -K81317002P .
- **Çertifikatë** nr.**551** Prot ,Nr.Vendimi **10** , datë 24.10.2008 , lëshuar nga MMPAU në emër të **EMC Studio** .
- **Çertifikatë** nr.**5113** Prot ,Nr.Ident.146 , datë 08.07.2013 , lëshuar nga MMPAU në emër të **Elidiana Shehu**
- **Çertifikatë** nr.**11657** Prot ,Nr.Ident.261 , datë 10.12.2014 , lëshuar nga MMPAU në emër të **Altin Ahmeti**

Shtetasja e mësipërme deklaron nën përgjegjësinë e saj personale,në njohje të plotë të pasojave që sjell një dokument i fallsifikuar,se ky dokument është original .

Pasi verifikova se dokumenti i mësipërm nuk ka korrigjime,shtesa,fshirje e shenja të tjera dhe bazuar në nenin nr.56 të ligjit nr.7829 dt.01.06.1994 »Për Noterinë « *(i ndryshuar)* dhe Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr.6291 datë 17.08.2005 pika 3,4,7 Unë Noterja vërtetoj se :

« Njësitë janë kopje të njëjta me dokumentacionin original ».

NOTERE
Albana Skana

PULLE TARIFE



LICENCË



LN-7282-01-2014
Subjekti: ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS
Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Bulevardi "Bajram Curri", Pallatet
Agimi, Shkalla 4, Apartamenti 68
Kodi: III.Z.A (1+2)
Data e lëshimit: 16/01/2015
Kod tjetër:
Afati i vlefshmërisë: Paafat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis. (Auditim mjedisor dhe
Vlerësimi i ndikimit në mjedis.)

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Venditja kryesore së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nënshkrimi i sportelit:

Shesh Balliu





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë, Tel: 270 630, Fax: 270 627; www.moe.gov.al

Nr. 551 Prot.

Tiranë më 14/12 2008

Vendimi Nr. 10

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 268, datë 24.04.2003
"Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe
auditimit mjedisor".

EMC Studio

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për
të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme
mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të
ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

Ministri

L. Xhuvelli
Luftan **XHUVELLI**





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore
Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit
Sektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Rruga "Durrësit" Nr. 27 Tiranë, Tel. 04 2256 113 Fax. 04 2270 627 - www.moe.gov.al

Nr. 51/13 Prot.

Tiranë, më 28.07 2013

Nr. identifikues 146

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011
Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të
Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për
pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe
auditimin mjedisor".


Znj. ELIDIANA SHEHU

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për
të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme
mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të
ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Fatmir MED





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 11657 Prot.

Tiranë, më 10.12 2014

Nr. identifikues 261

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. ALTIN AHMETI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Lefter KOKA

